



| | | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|---------------------|
| Planuar / Dorezuar Prinijeno/Prodato Received/Delivry | 27-06 | 2022 | 2 | viti god year |
| Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity | |
| SKPMSTICK | 3757/2022 | | 1/5 | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.306/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2050/2019 të datës 23.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.306/2019 të datës 03.06.2019 e parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me numër 1122 të datës 07.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.306/2019 e datës 03.06.2019, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetë në fuqi Vendimi me numër 1122 i datës 07.05.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

A r s y e t i m

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, në bazë të autorizimit të datës 06.03.2019 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti të Administrimit të Shërbimit Civil, me datë 06.03.2019 me numër të referencës UHZ/009/19 ka shpallur konkursin e brendshëm për pozitën "Sekretar i Njesisë Akademike-Fakulteti i MTHM-së", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila ka marrë pjesë në të gjitha fazat e zhvillimit të procedurës së rekrutimit.

Menaxherja e Personelit e Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë me datë 26.03.2019 me numër 699 përgatitë raportin final duke u bazuar në raportin e Komisionit për Rekrutim për mos përzgjedhjen e asnjërit nga kandidatët për vendin e punës "Sekretar i Njesisë Akademike-Fakulteti i MTHM-së", me arsyetimin se as njëri nga kandidatët nuk i ka plotësuar kriteret

për emërim dhe i njëjtë raport aprovohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Universiteti "Haxhi Zeka".

Ankuesja me datë 27.03.2019 njoftohet se asnjëri nga kandidatët nuk i ka fituar pikët e mjaftueshme për emërim dhe se e pa kënaqur me këtë njoftim me datë 25.04.2019 parashtron ankesën me numër 1025 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë me pretendim ankimor kundër procesit të rekrutimit dhe shkeljeve nga e drejta e punës që nga Akt emërimi me numër 1785 i datës 27.07.2017 sipas numrit të referencës 1455/2017 që i bëhet ndryshimi i titullit të vendit të punës nga pozita Sekretare e Njesisë Akademike në Zyrtare për Çështje Juridike Fakulteti i Biznesit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, me datë 07.05.2019 merr Vendimin me numër 1122 me të cilin vendim në dispozitivin e parë i refuzohet ankesa si e pa bazuar ankuses kundër njoftimit për procesin e rekrutimit ndërsa në dispozitivin e dytë ja hedh poshtë ankesën si të pasafatshme për shkelje të të drejtave nga marrëdhënia e punës.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin me numër 1122 të datës 07.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, me datë 03.06.2019 parashtron ankesë me numër të protokollit në 2547/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuses, ndërsa më datë 31.07.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 23.05.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2050/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 31.07.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 03.06.2019. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 27.05.2022 me numër të protokollit 3091/2022 e ka pranuar Aktgjykimin A.nr.2050/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 06.06.2019, ankesën e ankuses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë më datë 19.06.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative i datës

27.05.2022; Kërkesa e ankueses për mos vendosje nga ana e Këshillit e datës 30.07.2019; Njoftimi i datës 31.07.2019; Ankesa e ankueses e datës 03.06.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 07.05.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesa e ankueses e datës 25.04.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Marrëveshje mirëkuptimi ki datës 28.02.2012; Akt emërimi i ankueses i datës 27.07.2017; Vendimi i datës 06.05.2014; Akt emërimi i ankueses i datës 28.06.2018; Kontratë pune e ankueses e datës 05.06.2009; Procesverbali i datës 26.04.2019, 30.04.2019 dhe i datës 03.05.2019 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; e-mail i datës 07.05.2019; Njoftim i datës 03.04.2019 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për hapjen e procedurave të rekrutimit të nivelit të lartë drejtues; Raporti final i datës 26.03.2019; Kërkesa e datës 08.02.2019 për fillimin e rekrutimit (Form.MAP-SHCK-01); Shpallja e rekrutimit (Form.MAP-SHCK-02); Regjistri i aplikacioneve të pranuar (Form.MAP-SHCK-04); Përcaktimi i kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë (Form.MAP-SHCK-05); Njoftimi i kandidatëve për testim nga përzgjedhja e ngushtë (Form.MAP-SHCK-06); Përcaktimi i kriterëve për testin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj (Form.MAP-SHCK-07a); Përmbledhja e vlerësimeve individuale (Form.MAP-SHCK-09); Renditja përfundimtare e kandidatëve (Form.MAP-SHCK-10); Raporti final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues (Form.MAP-SHCK-11); Aprovimi nga MAP/DASHC i datës 06.03.2019; Lista e kandidatëve e datës 18.03.2019; Deklarata për formimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil e datës 06.03.2019; e-mail i datave 27.05.2019, 22.03.2019; 19.03.2019; 14.03.2019; 20.03.2019; Konkursi i brendshëm i datës 06.03.2019; Testi me shkrim; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj (Form.MAP-SHCK-08a); Aplikacioni i kandidatit me shkresat e bashkangjitura; Aplikacioni i kandidatit me shkresat e bashkangjitura; Aplikacioni i kandidatës me shkresat e bashkangjitura; Aplikacioni i kandidatës me shkresat e bashkangjitura; Aplikacioni i kandidatës me shkresat e bashkangjitura si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është *e pa bazuar sepse*;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila ka pretenduar se procedura e rekrutimit për vendin e punës "*Sekretar i njësisë Akademike-Fakulteti i MTHM-së*", ka pas aplikim të gabuar dhe shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit për Shërbyesit Civil dhe Rregullores së rekrutimit, verifikimit të gabuar dhe jo të plotë i gjendjes faktike si dhe e kundërshton dispozitivin e dytë të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 07.05.2019 për hedhje poshtë si të jashtë afatshme pretendimin e saj ankimor për shkelje të të drejtave të marrëdhënies së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke u bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, ka analizuar gjithë procesin e rekrutimit dhe ka për pozitën "*Sekretar i njësisë Akademike-Fakulteti i MTHM-së*" e shpallur nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë dhe ka konstatuar se Menaxherja e Personelit me datë 26.03.2019 ka përgatitur raportin final për procedurën e rekrutimit për vendin e punës "*Sekretar i njësisë Akademike-Fakulteti i MTHM-së*" për mos përzgjedhje të asnjërit nga kandidatët pasi që

kandidatët nuk i kanë plotësuar kriteret për emërim dhe se raporti aprovohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se në konkursin brendshëm për pozitën "Sekretar i njësisë Akademike-Fakulteti i MTHM-së", të datës 06.03.2019 me numër të referencës UHZ/009/19 i cili konkurs ka qenë i hapur nga data 06.03.2019 gjer më datën 15.03.2019, kanë aplikuar gjithsej pesë (5) kandidatë, ne mesin e tyre edhe ankuesja e cila është përfshirë në listën e ngushtë me datë 18.03.2019 dhe Kolegji konstson se Komisioni Përzgjedhës në kete rast ka vepruar drejtë dhe në pajtim me nenin 28 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 neni 2, 3, 4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku thuhet: "*Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim:...,1.2. përvojën e punës*", *secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter. Numri maksimal i secilit kriter është 20 pikë. Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura te tjera është 40 pikë. Kandidatet, të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes*".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu bazuar ne dëshmitë e ofruara ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri në përgatitjen e raportit final te rekomandimit, ka vepruar drejtë duke bërë vlerësimet e testit me shkrim dhe me gojë si për ankuesen, po ashtu edhe për kandidatet qe kane aplikuar duke vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 37 dhe 39 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe në bazë të vlerësimeve të kandidatëve që kane aplikuar: _____ ka arritë gjithsejtë 33.25 pikët e pergjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, _____ ka arritë gjithsejtë 32.25 pikët e pergjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, _____ ka arritë gjithsejtë 27.25 pikët e pergjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, dhe _____ ka arritë gjithsejtë 26.75 pikët e pergjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, ndërsa ankuesja ka arritë gjithsejtë 54.6 pikët e pergjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, dhe është e renditur e para në listë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të fakteve të lartcekura gjegjësisht në bazë të formularit Form.MAP-SHCK-10 të renditjes përfundimtare të kandidatëve, ka konstatuar se asnjëri nga kandidatët nuk ka arritur që ti grumbullojë pikët e mjaftueshme për emërim ashtu siç është e përcaktuar me dispozitat e nenit 40 paragrafit 1, 2 dhe 3 i Rregullores 02/2010 për Procedura të Rekrutimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: "*Pikët e kërkuara për emërim: 1. Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë*", *2. Pikët e përgjithshme në testimin me shkrim dhe me gojë mbliidhen dhe pjesëtohen për dy*" dhe *3. Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai, i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe me gojë) ka jo më pak se 60% të maksimumit të pikave të caktuara*", andaj ne rastin konkret Kolegji ka konstatuar Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e mos rekomandimit për emërim te asnjërit prej kandidateve qe kane aplikuar ka vepruar ne pajtim me dispozitat e nenit 40 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Rregullores 02/2010 për Procedura të Rekrutimit në Shërbimin Civil për shkak se asnjëri nga kandidatët duke përfshi edhe ankuesen nuk ka arritur që të grumbullojë pikët e kërkuara sipas dispozitës së lartë cekur për emërim, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka shqyrtuar edhe pretendimin ankimor të ankueses lidhur me ndryshimin në mënyrë të kundërligjshme të Aktit të Emërimit nga pozita „Sekretar“ në pozitën „Zyrtar për Çështje Juridike“ dhe në baze të dëshmive të ofruara nga organi i punësimit ka konstatuar se pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm sepse ankuesja me datë 28.06.2012 ka nënshkruar Akt emërimit me Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit në vendin e punës „Sekretare“, dhe pas Marrëveshjes së Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Universiteti të Prishtinës dhe Universitetit Publik „Haxhi Zeka“ në Pejë, me Vendimin me numër 01-579/14 të datës 06.05.2014 Sekretari i Përgjithshëm ankuesen Sekretare e Përgjithshme e UHZ-së e kthehen në pozitën paraprake në vendin e punës „Sekretare e Fakultetit të Biznesit dhe MTHM-së“ prej datës 01.04.2014 më pastaj me datë 07.11.2018 Sekretari i Përgjithshëm merr vendimin me numër 2945 të datës 07.11.2018 me të cilën vendim i aprovohet kërkesa e ankueses për transferimin e përhershëm në vendin e punës „Zyrtare për Çështje Juridike“ në Njësinë Akadematike të Fakultetit MTHM-së, i cili transferim është bërë në pajtim me nenin 8 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Universiteti „Haxhi Zeka“ në Pejë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 1122 të datës 07.05.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.306/2019

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gaspaçiu BIRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universiteti „Haxhi Zeka“ në Pejë;
- Udhëheqësit të Personelit në Universiteti „Haxhi Zeka“ në Pejë dhe
- Arkivat të KPMSHCK-së.

